



The World Bank Centre for Financial Reporting Reform

# REPARIS


Rruga drejt Europës: Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimi Institucional



## Përditësime të direktivave të reja të kontabilitetit të BE-së

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE  
PËR PËRMIRËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR  
NJË MEKANIZËM PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM  
16 MAJ 2013

me mbështetjen bujare të

 Austrian  
Development Cooperation

 **BMF**  
FEDERAL MINISTRY  
OF FINANCE




LE GOUVERNEMENT  
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG  
Ministère des Finances



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

# Regjimet e raportimit financiar të BE-së



# Konteksti i direktivave të propozuara: pse ndryshim? (i)

- » Kriza e vazhdueshme financiare dhe ekonomike kërkon reforma për të gjallëruar rritjen
- » Përgjigja e BE-së:
  - Europa 2020: BE-ja po punon për të lëvizur me vendosmëri përtej krizës dhe për të krijuar kushtet për një ekonomi më konkurruese me punësim më të lartë: e shpejtë, e qëndrueshme, me rritje gjithëpërfshirëse
  - Axhenda e BE-së për një rregullim më të mirë: për të pakësuar barrën administrative të ndërmarrjeve të vogla që ato të përqëndrohen në rritjen e biznesit, dhe për të krijuar kushte më të mira për akses në burime financimi
- » Nevoja për një kuadër raportimi më konsistent në të gjithë BE-në, të diferencuar për shoqëri me madhësi të ndryshme
- » Direktivat mbi kontabilitetin po riorganizohen për të fituar qartësi dhe për të vendosur kushte të barabarta në vendet e BE-së

# Konteksti i direktivave të propozuara: pse ndryshim?(ii)

- » Direktivat të BE-së mbi kontabilitetin janë hartuar para më shumë se 30 viteve
- » Ndryshimet në direktiva kanë shtuar shumë kërkesa
  - Dhënia e informacioneve shpjeguese
  - Rregullat e vlerësimit, përfshirë trajtimet për vlerën e drejtë
- » Më pak vëmendje për të thjeshtuar ose hequr kërkesat ekzistuese, përfshirë alternativat për Vendet Anëtare (VA) që nuk favorizojnë krahasueshmërinë
- » Rritja e kompleksitetit është një barrë për ndërmarrjet e vogla
- » Njësitë Ekonomike me Interes Publik kanë tashmë regjimin e tyre: Rregulloren e SNK-ve
- » NVM-të përfaqësojnë 99 përqind të tregut

Përqasja “Think small first”






## » **Objektiva e Përgjithshme: Funkcionim më i mirë i Tregut të Përbashkët:**

- Rritja e aksesit në burime financimi
- Reduktimi i kostos së kapitalit (efekti i transparencës)
- Rritja e nivelit të tregtisë ndërkufitare
- Bashkimi dhe blerja e aktiviteteve të biznesit

## » **Duke vendosur kërkesa për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar për:**

- Të patur më pak barrë në përgatitjen e pasqyrave financiare
- Rritjen e qartësisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare brenda BE-së
- Mbrojtjen e nevojave thelbësore të përdoruesve

- » Gjatë përgatitjes së direktivave të reja të kontabilitetit Komisioni European ndryshoi një pjesë të terminologjisë:
  - Shoqëri  Ndërmarrje
  - Llogari  Pasqyra Financiare
  - Raport Vjetor  Raportet e menaxhmentit
- » Këto ndryshime u bënë për të lidhur formulimin e direktivës së re me gjuhën moderne të kontabilitetit

# Ndërmarrjet e Vogla

Ndërmarrjet e vogla	Karakteristikat kryesore të ndryshimeve në direktivën e re
<p>1.1 milion ndërmarrje</p> <p>21 % e ndërmarrjeve</p> <p><b>Pragjet e reja:</b> <b>Totali i aseteve:</b> 5 milion Euro <b>Xhiroja neto:</b> 10 Euro <b>Punonjësit (mesatare):</b> 50</p>	<p>Harmonizim maksimal</p> <p>Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare – të kufizuara në numër - pesë fusha kryesore</p> <p>Nuk ka kërkesa për auditim ligjor</p> <p>Grupet e vogla përjashtohen nga përgatitja e pasqyrave të konsoliduara financiare</p>

KE-ja duhet të rishikojë periodikisht pragjet - për të ruajtur me kalimin e kohës vlefshmërinë e pragjeve

# Një regjim i thjeshtëzuar për ndërmarrjet më të vogla

- » Pranimi i një regjimi të veçantë për ndërmarrjet e vogla për të zvogëluar barrën administrative
  - Nuk ka detyrime për auditim ligjor
  - Kufizimi i dhënies së informacioneve shpjeguese:
    - Politikat kontabël
    - Garancitë dhe angazhimet e panjohura në bilanc (më shumë mbrojtje për kreditorët)
    - Ngjarjet pas bilancit
    - Borxhet afatgjata dhe të siguruara
    - Transaksionet me palët e lidhura (më shumë mbrojtje për kreditorët)
- » Për disa vende kjo do të sillte kërkesa shtesë për shënime shpjeguese, sepse nuk do të ketë alternativa për VA-të për t'i hequr këto kërkesa



harmonizim maksimal



# Ndërmarrjet e Mesme dhe të Mëdha

Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha	Karakteristikat kryesore të ndryshimeve në direktivën e re
<p>0.3 milion ndërmarrje</p> <p>4 % e ndërmarrjeve</p> <p><b>Pragjet e reja për ndërmarrjet e mesme:</b></p> <p><b>Totali i aseteve:</b> 20 milion Euro <b>Xhiroja neto:</b> 40 milion Euro <b>Punonjësit (mesatare):</b> 250</p> <p><b>Ndërmarrjet e mëdha</b> sipër pragjeve të vendosura më lart</p>	<p>Prezantimi i një parimi të përgjithshëm materialiteti dhe përmbajtja mbi formën</p> <p>Reduktim në numrin e alternativave për Vendet Anëtare (VA)</p>

- » Më shumë harmonizim në dhënien e informacioneve shpjeguese dhe regjime për dhënien e informacioneve shpjeguese më të krahasueshme për të njëjtat lloje ndërmarrjesh
- » Prezantimi i parimit të përgjithshëm të materialitetit lejon kombinimin e zërave në Fitim/Humbje ose Bilanc, heqjen e informacioneve shpjeguese të parëndësishme; niveli i materialitetit është përgjegjësi e shoqërisë
- » Kërkesa për të paraqitur realitetin ekonomik të një transaksioni në pasqyrat financiare, dhe jo vetëm formën e tij ligjore

- » Paraqitja vetëm të një formati bilanci në vend të dy formateve të cilët përgatiteshin më parë
- » Dy formate për pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në vend të katër të tillave, për krahasueshmëri të zgjeruar:
  - sipas natyrës
  - sipas funksionit
- » Heqja e të ardhurave dhe shpenzimeve të jashtëzakonshme

- » Nga një qasje me alternativa për Vendet Anëtare, në një qasje të harmonizuar
  - Të gjitha ndërmarrjet në një kategori të caktuar (të vogla, të mesme dhe të mëdha) do të jenë të krahasueshme në të gjithë BE-në
  - Përqasje e detajuar në shënimet shpjeguese
    - Më shumë kufizime në dhënien e informacioneve shpjeguese për ndërmarrjet e vogla
    - Kërkesa shtesë për ndërmarrjet e mesme
    - Kërkesa shtesë për ndërmarrjet e mëdha dhe njësitë ekonomike me interes publik
- » **Por** shënime të reja shpjeguese të detyrueshme për të gjitha ndërmarrjet për të cilat Vendet Anëtare kanë pasur alternativën për të mos raportuar
  - Ngjarjet pas bilancit
  - Transaksionet me palët e lidhura, përfshirë ndërmarrjet tërësisht në pronësi

- » Regjimi për NJEIP nuk varet nga madhësia: zbatimi i Rregullores së SNK 2002/1606
- » Direktiva e Re e Kontabilitetit:
  - Deklarata e drejtimit korporativ në raportin e menaxhmentit është detyrim vetëm për NJEIP
  - Shënime shpjeguese shtesë vetëm për NJEIP:
    - Raportimi për segmente
- » Tarifat totale për auditimin ligjor, shërbime të tjera auditimi, për shërbime konsulence fiskale dhe për shërbime të tjera joauditimi

- » Nuk trajtohen më si një opsjon politikash
- » Mbeten pak dallime ndërmjet direktivave të reja të kontabilitetit dhe SNRF për NVM-të
  - Amortizimi i emrit të mirë (5 vjet në direktivë/10 vjet në SNRF për NVM-të)
  - Prezantimi i aksioneve të nënshkruara por të papaguara
- » SNRF për NVM – Vendet Anëtare mund t'i adoptojnë për të gjitha ose disa shoqëri të palistuara **me kusht që** Direktiva të zbatohet plotësisht, dhe standardi të ndryshohet në përputhje me çdo kërkesë kontabiliteti të Direktivës që ndryshon nga SNRF për NVM-të
- » Ndryshimet/Rishikimet e SNRF për NVM-të mund të minimizojnë dallimet (ose t'i bëjnë ato më të mëdha)

- » KE ka nxjerrë një Direktivë në shkurt 2012 që i lejon Vendet Anëtare të aplikojnë një regjim të lehtë raportimi për mikro-ndërmarrjet
- » Ndërmarrjet mikro kanë dy nga karakteristikat e mëposhtme:
  - Më pak se 10 punonjës
  - Xhiro vjetore më pak se 7 milion
  - Më pak se 3 milion asete totale
  - Detyrimi për të përgatitur një bilanc të thjeshtuar, dhe një pasqyrë të thjeshtuar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pa shënime shpeguese, me përjashtim të
    - Angazhimeve me anë të garancisë
    - Paradhëniet dhe kreditë e dhëna për anëtarët e organeve administrative, menaxheriale dhe mbikëqyrëse
    - Blerjet e aksioneve të veta

- » Të drejta dhe detyrime të konstatuara të thjeshtëzuara me përjashtim të kostos së lëndës së parë dhe lëndës së konsumueshme, rregullimeve të vlerës, kostos së stafit dhe tatimeve ... nuk ka vlerë të drejtë
- » Heqja e detyrimit për të paraqitur “Parapagimet dhe të ardhurat e konstatuara” dhe “të drejtat dhe detyrimet e konstatuara dhe të ardhurat e shtyra”
- » Detyrimi për të dorëzuar bilancin dhe shënimet shpjeguese tek autoritetet
- » Pa raport të menaxhmentit



- » Teksti i ri i arritur me kompromis në parlamentin e BE-së - prill 2013
- » Disa ndryshime rideklarojnë dispozitat e direktivave të mëparshme (p.sh. dy formatet e bilanceve, metoda LIFO)
- » Kjo do të thotë - shkallë më të vogël harmonizimi në praktikat e kontabilitetit në të gjithë BE-në krahasuar me atë që ishte parashikuar fillimisht nga Komisioni
- » Ndikimet për Shqipërinë nuk janë krejtësisht të qarta edhe pse fakti se një numër alternativash ende mund të ofrohen në direktivë që do të thotë se transpozimi i direktivës mund të jetë më i lehtë meqenëse vendet do të kenë një sërë mundësish për të zgjedhur


# REPARIS

Rruga drejt Europës: Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimi Institucional



## Faleminderit!

me mbështetjen bujare te

 Austrian  
Development Cooperation

 **BMF**  
FEDERAL MINISTRY  
OF FINANCE



LE GOUVERNEMENT  
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG  
Ministère des Finances



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra